



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 5, Datë 09.09.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “REHABILITIMIN E ZYRAVE TË
KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, nenit 19 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Rehabilitimin e zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, me vendndodhje në territorin e Bashkisë Tiranë, me subjekt kërkuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturës bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

Adelina Greca



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT